REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr.1252/6 prot.

Tiranë, më 29.9.2026

V E N D I M
Nr.34, datë 29.9.2026

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË STAFIT PEDAGOGJIK ME KOHË TË PJESSHME, SPECIALISTËVE, PEDAGOGËVE NË DISPOZICION DHE ASISTENT PEDAGOGËVE NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Në mbështetje të nenit 248, 264 të ligjit nr. 115/2016, "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 31.1.2017 (i ndryshuar), Këshilli Drejtues i mbledhur më datë 29.9.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion, specialistëve dhe asistent pedagogëve në Programin e Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëngjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Të miratojë listën e pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion, specialistëve dhe asistent pedagogëve në Programin e Formimit Fillestar për kandidatët për ndihmës ligjor, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëngjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.